

Nr. 1183 / prot.,

3

Tiranë, më 27.05.2025

**VENDIM**

Nr. 26, datë 27 .05.2025

**PËR**

**“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE ME NOTË MESATARE 9-10, TË CILËT PËRFITOJNË BURSË STUDENTORE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 DHE STUDIOJNË NË NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË INTEGRUAR NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr.329/24 prot., datë 18.04.2025 “Kërkesë për miratimin e përfitimit të bursës studentore dhe përjashtimit nga tarifa e shkollimit për dy student të Fakultetit të Mjekësisë Dentare për vitin akademik 2024-2025”,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë listën e 2 (dy) studentëve, me notë mesatare 9-10, të cilët përfitojnë bursës studentore dhe përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025 dhe studiojnë në një program studimi të ciklit të integruar, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar për bursën studentore është 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë dhe për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit është 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë. Ky efekt mbulohet nga fondet grant të buxhetit të shtetit për vitin 2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**KRYETAR  
ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË**

**MONIKA FIDA**

**VERA OSTRENI**

**ALBANA GJINOPULLI**

**ANIS THODHORJANI**

**ALTINA XHAFERI**

**ENDRIT YZEIRAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
ADMINISTRATORI

Nr. 329/24 Prot.

Tiranë, më 18.04.2025

Lënda: Kërkesë për miratimin e përfitimit të bursës studentore dhe përjashtimit nga tarifa e shkollimit për dy student të Fakultetit të Mjekësisë Dentare për vitin akademik 2024-2025.

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË**

E nderuar Kryetare,

Të nderuar Anëtarë të Bordit të Administrimit,

Fakulteti i Mjekësisë Dentare, nëpërmjet shkresës nr.518/6, date 24.01.2025, protokolluar në Rektoratin e UMT-së me nr.181 datë 27.01.2025, ka përcjellë listën e studentëve ekselent të vitit të katërt dhe të pestë të cilët plotësojnë kriteret për të përfituar bursë dhe tarifë gjatë vitit akademikë 2024-2025.

Studentët Aldrin Ponari dhe Kaltina Kasmollari, janë student ekselentë dhe studiojnë në një program studimi të integruar në UMT, dega Stomatologji.

Emrat e këtyre studentëve nuk kanë qenë të përfshirë në listat paraprake të dërguara nga fakulteti për studentët ekselentë, viti i dytë e lartë, të cilët janë miratuar nga Bordi i Administrimit për përfitimin e bursës dhe tarifës gjatë vitit akademik 2024-2025 me Vendimin nr. 51 dhe 52 datë 27.12.2024

Për sa më sipër, në vijim të kërkesës së fakultetit, si dhe në zbatim të VKM-së nr. 269, datë 29.03.2017, e ndryshuar dhe VKM-së 903, datë 21.12.2016, e ndryshuar, i propozojmë Bordit të Administrimit miratimin e përfitimit të bursës dhe përjashtimit nga tarifa e shkollimit për këta dy studentë, për vitin akademikë 2024-2025.

Efekti financiar total për bursën e shkollimit është 180,000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë dhe për përjashtimin nga tarifa e shkollimit është 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë dhe përballohet nga fondet grant të buxhetit të shtetit.

Bashkëlidhur lutem gjeni, shkresën nr.518/6, datë 24.01.2025, të Fakultetit të Mjekësisë Dentare .

*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,*

ADMINISTRATOR  
ARLIND BROCI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr 518/ Prot  
16

Tiranë më 29/01 /2025

**LËNDA :** Dërgohet "Lista e studenteve me mesatare 9-10" për vitin akademik 2024-2025

**ADMINISTRATORIT TE UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË , TIRANË**

Në vijim po Ju dërgojmë Shkresën Nr. 518/5 datë 16.01.2025 me plotësimin e listës së studenteve me mesatare 9-10 për vitin akademik 2024-2025.

**Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,**

**ADMINISTRATOR FMD**

**Oltian SHERA**



Nr. 518/3 Part

16.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Tiranë, më 16.01.2025

**Lënda :** Plotësim i listës emërore të studentëve me mesatare 9-10, viti akademik 2024-2025

**Drejtuar:** **Oltian Shera**  
Administrator i FMD-së

Në vijim të shkresës Nr. 518/3, datë 14.11.2024, ju përcjell edhe emrat e dy studentëve, të cilët kanë mesataren e ponderuar 9-10 me të gjitha kreditet e plotësuara, të vitit të kaluar akademik 2023-2024, si më poshtë vijon:

| Nr. | Programi i studimit | Vtiti i studimit | Emer     | Mbiemer    |
|-----|---------------------|------------------|----------|------------|
| 1   | Stomatologji        | IV               | ALBDRIN  | PONARI     |
| 2   | Stomatologji        | V                | KALTRINA | KASMOLLARI |

**K/SEKRETARE**

**Natasha LIKA**